



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). (shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 27.06.2023 dhe 25.07.2023.)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Brikena Ukperaj.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.*
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 9. BIRN.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). (shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 27.06.2023 dhe 25.07.2023.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë me rendin e ditës i cili është i datës 21 shtator.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot nga ana e KLGJ-së do merren në shqyrtim rreth 13 çështje. Përpara se të kalojmë, nëse jeni dakord me rendin e ditës, kërkoj ndjesë për të gjithë të ftuarit në mbledhje pasi Këshilli në fakt filloi me vonesë, duke qenë se sot nga ana e Këshillit do kalohet një nga projekt-aktet që ka të bëjë me miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe nga ana e Këshillit u diskutua lidhur me konsolidimin e projekt-aktit, duke qenë se dy anëtarë kishin sjellë

propozime dhe ishin pranuar nga Komisioni. Komisioni bëri reflektimet për t'ia përcjellë mbledhjes plenare.

Pa humbur kohë po kalojmë tek rendi i ditës.

Jemi dakord me rendin e ditës?

Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Lidhur me pikën që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së zotit {...}, unë kam një kërkesë, që para se të shprehet lidhur me këtë çështje dhe të kemi një vendimmarrje, unë dua që të marrim një informacion shtesë pranë Komisionit të Ligjeve lidhur me relacionin e përgatitur për këtë ligj dhe diskutimin që kanë pasur për propozimet përkatëse, që referohen edhe tek kërkesa e zotit {...}.

Naureda Llagami: Dakord.

Duke qenë se nga ana e Këshillit gjithmonë kemi mbajtur standardin që kur kemi kërkesë për informacion për çështjen, atëherë jemi dakord që ta heqim nga rendi i ditës për ta kaluar në momentin që administrohet informacioni i kërkuar nga zonja Plaku. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek akti i cili ka të bëjë me miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Pa humbur kohë unë dua që t'ia jap fjalën shkurtimisht z. Kurushi, i cili do prezantojë projekt-aktin. Ju sjell në vëmendje që ky projekt-akt është futur në mbledhjen plenare që në qershor, por për shkak të diskutimeve dhe propozimeve që ka pasur nga kolegët, atëherë zotit Kurushi iu la detyrë që të bënte një konsolidim dhe vlerësim të të gjithë propozimeve të sjella nga zonja Ukperaj, por gjithashtu ka administruar propozime pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës edhe zoti Alban Toro. Kështu që për t'i rënë më shkurt unë do doja nga zoti Kurushi lidhur me draftin që i ka propozuar sot mbledhjes plenare pas shqyrtimit të këtyre propozimeve.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Pas shqyrtimit të dy propozimeve, si dhe diskutimeve që kemi bërë bashkërisht me njëri-tjetrin, kemi arritur në disa konkluzione të përbashkëta të cilat unë po i përmend një nga një.

Atëherë, në rregulloren për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, neni 1 i rregullores, neni 2, neni 3 i saj, nuk kemi ndryshime dhe nuk kemi propozime. Janë propozime të përbashkëta të miat dhe të zonjës Ukperaj. Do shikoni nenin 2 të zonjës Ukperaj që ka bërë “Përkufizime”, i qëndrojmë këtij propozimi. Pra një, dy dhe tre.

Neni 4, është një propozim, pas paragrafit të parë është propozimi i paraqitur nga zoti Toro, i cili thotë: “Në vijim të paragrafit të parë të shtohet edhe fjalia “Në të merr pjesë si vëzhgues edhe një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor””.

Më tej, për paragrafin e dytë kemi pasur diskutime dhe ndryshime në përmbajtjen e saj, të cilat jemi të dakordësuar.

Vazhdojmë, neni 5, kemi një propozim të ri të zotit Toro, pas paragrafit të parë të shtohet një paragraf i dytë. Paragrafi i dytë ekzistues bëhet paragrafi i tretë i propozimit të zonjës Ukperaj dhe paragrafi i tretë bëhet paragrafi i katërt. Edhe paragrafi i tretë dhe i katërt kanë disa ndryshime të diskutuara që i referohen kryesisht teknikës legislative.

Vazhdojmë më tej.

Neni 6 qëndron ashtu siç është.

Tek neni 7, paragrafi i parë dhe paragrafi i dytë referuar termave, nocioneve,

“dokumentacionit të depozituar prej tyre”, ne jemi dakordësuar që t’i heqim edhe në paragrafin e parë edhe në paragrafin e dytë.

Neni 8, jemi dakordësuar, nuk kemi probleme. Është propozim i zonjës Ukperaj i shtuar paragrafi i parë që është “Njoftimin e gjyqtarëve për datën, ditën dhe orën e mbledhjes”, pra jemi dakord për këtë.

Shkojmë tek neni 9. Në lidhje me nenin 9 ne kemi bërë disa ndryshime pas diskutimeve. E para, titulli është “Lista e kandidatëve” dhe jo “Verifikimi i kriterëve për kandidatët” dhe në të janë bërë ndryshime, ku “kryetari i mbledhjes së përgjithshme përgatit listën e kandidatëve që kanë shprehur interes. Për këtë qëllim, kryetari i mbledhjes i kërkon informacion Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Ky është neni 9.

Neni 10, kemi bërë një ndryshim duke iu referuar propozimit të bërë nga zonja Ukperaj dhe dakordësohemi me këtë ndryshim në titull, pra “Zhvillimi i mbledhjes”, në vend të “Drejtimin të mbledhjes”, sepse është përsëritur dy herë tek neni 4.

Neni 11 i zonjës Ukperaj i korrespondon nenit 9 që diskutuam neve paraprakisht.

Në nenin 12 ne kemi bërë ndryshimin dhe është i përngjashëm me atë çfarë thashë për nenin 9 për gjyqtarët që kanë shprehur interes, në mbledhjen e përgjithshme, kandidatët që plotësojnë kriteret ligjore, si dhe përfshimë edhe prezantimin e platformës në mbledhje nga kandidatët që kanë shprehur interes. Kjo është pjesë e nenit 12.

Kemi shtuar nenin 13 për detyrat e komisionit dhe është propozim i bërë nga zonja Ukperaj.

Vazhdojmë neni 14 është “Përmbajtja e fletës së votimit”, dakordësohemi me propozimin e zonjës Ukperaj.

Neni 15 “Procesi i votimit”, pika e dytë, paragrafi i dytë kemi thënë: “Procesi i votimit është i mbyllur...”. Pas diskutimeve që kemi bërë me njëri-tjetrin, referuar propozimit të zotit Toro, themi që “Procesi i votimit është i hapur”. Pra nga “i mbyllur”, dakordësohemi dhe themi që votimi është i hapur.

Neni 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 janë sipas propozimeve të bëra nga zonja Ukperaj, duke marrë në konsideratë edhe propozimet e mia që i ka marrë në konsideratë vetë zonja Ukperaj. Kështu që jemi dakord me këtë pjesën.

Pas këtyre janë edhe formularët përkatës, kërkesa për shprehjen e interesit për

pozicionin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, si dhe është fleta e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Tani është vetëm një diskutim i bërë në mbledhje, (e kemi vënë modelin përkatës) nëse kandidati për Kryetar të Gjykatës së Lartë është vetëm një, pra nuk ka të tjerë, mos do duhet që për një të bëjmë edhe një model ku vota të jetë “pro” ose “kundër”? Se nuk mund të ketë të tjerë. Pra nëse ka 2, 3, 4, duhet votimi. Shenja “x”, “y” për atë që dëshiron secili nga kandidatët. Por nëse kandidati është i vetëm do duhet që tek rubrika e votës të themi “pro” ose “kundër”. Nuk lejohet abstenimi.

Këto janë propozimet e bëra bashkërisht nga të gjithë së bashku.

Faleminderit për vëmendjen!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, pasi ta kalojmë në votim në tërësi komplet materialin për projektregulloren, unë në fakt do të doja që edhe një herë për konfirmim t’ua përcjellim me e-mail para se të zbardhim plotësisht të gjithë propozimet që sot u dakordësuam si nga propozimet e ardhura nga zonja Ukperaj, ashtu edhe propozimet e ardhura nga zoti Toro. Kështu që pasi ta miratojmë stafi administrativ duhet t’ia përcjellë me ngjyrë të gjithë propozimet e miratuara nga mbledhje.

Kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi rregulloren për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për shkak të një angazhimi zonja Llagami është në pamundësi për të vazhduar drejtimin e mbledhjes, ndaj vijimi i mbledhjes do të drejtohet nga zoti Rusi.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Brikena Ukperaj.***

Shënim: Zonja Llagami largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.*
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 9. BIRN.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Irena Plaku.

Ilir Rusi: Sikundër u bë më dije, mbledhja në vijim do të drejtohet nga unë, Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga relatore zonja Irena Plaku. Për këtë çështje, nga ana e zotit {...} është kërkuar prezenca e tij në këtë mbledhje.

Sipas konfirmimit, prezent në sallë është edhe zoti {...}.

Për më tej fjalën ia jap relatores për të relatuar relacionin përkatës.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë shkurtimisht po ju paraqes projektraportin e vlerësimit për gjyqtarin {...} për vitin 2022, që është vlerësim i përsheptuar i detyruar, për shkak të kërkesës së tij për ngritje në detyrë.

Procedura për vlerësimin ka filluar me vendimin e KLGJ-së nr. 144, datë 28.03.2023. janë vijuar procedurat për marrjen e informacioneve përkatëse, hedhjen e shortit, administrimin e dosjeve, dhe marrjen e akteve nga organet e tjera.

Me vendimin e datës 11.07.2023 është vendosur plotësimi i procedurës së dokumentacionit të vlerësimit për gjyqtarin {...}, si dhe janë bërë njoftimet përkatëse, është hartuar projektraporti i cili i është njoftuar gjyqtarit dhe ky i fundit ka paraqitur kundërshtime dhe prova të cilat i janë njoftuar menjëherë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më poshtë do të pasqyroj në mënyrë të përmbledhur analizën lidhur me kriteret e vlerësimit profesional të gjyqtarit, konkretisht për kriterin e parë, nëntreguesi “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, referuar analizës së të dhënave në raportin analitik, rezulton se gjyqtari përgjithësisht ka aftësi shumë të mira për përshkrimin dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët përgjithësisht paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar përgjithësisht provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit në të gjitha vendimet gjyqësore, ku rrethanat dhe faktet e çështjes paraqiten në mënyrë tepër koncize, pa u integruar gjithmonë me provat konkrete, dhe në disa raste pa u paraqitur ato në tërësi në pjesën përkatëse të vendimit. Gjithashtu gjyqtari ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyesimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj.

Në projektraport janë pasqyruar edhe disa mangësi të vërejtura në vendimet përkatëse ku konstatohet që nuk janë pasqyruar rrethanat e palëve siç duhet apo nuk është bërë një analizë e mirëfilltë e dispozitave përkatëse në raport me faktet e konstatuara në çështjet konkrete.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm, për këtë tregues është konstatuar se përgjithësisht gjyqtari bën interpretimin e normës duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete dhe e analizon normën në përputhje me faktin që ka rezultuar i provuar në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore janë analizuar dispozitat përkatëse, konkretisht neni 690 i K.Civil, nenin 155 të K.Punës, nenet 1 dhe 50 të K.Familjes, nenet 123, dhe 132, dispozitat përkatëse të Kodit të Familjes.

Gjithashtu janë cituar edhe dispozitat përkatëse në lidhje me çështjet penale të cilat analizohen nga ana e gjyqtarit.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet civile dhe penale. Konstatohet se gjyqtari ka aftësi të mira të interpretimit të dispozitave të ligjit material dhe procedural, duke bërë si interpretim abstrakt të normave, duke i integruar dhe me provat e marra. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit në interpretimin e ligjit në raport me provat e marra në shqyrtim si në çështjet penale dhe civile apo familjare. Në disa vendime burim vlerësimi, interpretimi i ligjit nuk është bërë referuar rrethanave dhe fakteve të provuara. Evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, si dhe ka treguar kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është mbi mesatare duke e pikëzuar me 20 pikë.

1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkuese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Edhe në këtë pjesë të raportit janë analizuar të dhënat që lidhen me vendimet gjyqësore që lidhen me vendimet gjyqësore burim vlerësimi ku janë evidentuar pjesët përbërëse të vendimit. Gjyqtari, në hartimin e vendimit, ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikëpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale apo të themelit të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese e arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë dhe në të gjitha rastet, këto pjesë janë ndarë në paragrafë, të cilat e lehtësojnë shumë të kuptuarit e vendimit duke mundësuar referimin në paragrafët e mësipërm. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse janë konstatuar disa vendime të cilat nuk kanë objektin përkatës për të cilin është shprehur gjyqtari apo palët ndërgjyqëse dhe për këtë arsye, lidhur me këtë tregues është vlerësuar se ka mangësi.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, vlerësoj se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në tituj dhe gjithmonë mendimi është i ndarë në paragrafë të numërtuar. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuar kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat përgjithësisht janë pjesë e rrethanave të faktit

dhe jo të ndarë më vete, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjese të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike. Por nuk konstatohet e njëjta qartësi në pjesën e parë të vendimit, konkretisht me paraqitjen e saktë të palëve ndërgjyqëse, të akuzës si dhe bazës ligjore, pasi në disa vendime, këto të dhëna nuk janë pasqyruara në mënyrë të saktë, të cilat janë të domosdoshme në lidhje me orientimin e gjykatave më të larta lidhur përmbajtjen e vendimit në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij. Gjithashtu, edhe pjesa e fundit e vendimit (dispozitivi) nuk është i qartë në lidhje me datën e shpalljes së vendimit (megjithëse del qartë nga data e vendimit të përshkruar në pjesën e parë të vendimit), si dhe disponimin mbi faktin nëse vendimi përbën titull ekzekutiv dhe kur lëshohet urdhri i ekzekutimit.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në këtë tregues është “mbi mesatare” duke e pikëzuar me 8 pikë.

1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Lidhur me këtë tregues, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në lidhje me këtë tregues. Konstatohet se vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësit të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumente të lidhura me njëri-tjetrin, duke i ndalur shkurtimisht tek evidentimi i lidhjes shkak- pasojë në raport me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes. Përgjithësisht gjyqtari i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me ligjin që gjen zbatim si dhe me rrethanat konkrete të çështjes, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin. Por nuk konstatohet e njëjta shkallë kujdesi në lidhje me argumentin logjik se si dispozitat gjejnë zbatim mbi faktet e provuar që përgjithësisht përshkruhen duke referuar herë pas here edhe aktet provuese, duke mos u analizuar në raport me njëra-tjetrën dhe fuqinë provuese të akteve konkrete.

Pas analizës së të dhënave lidhur me këtë tregues, vlerësoj se shkalla e aftësisë së tij është mbi mesatare duke e pikëzuar me 20 pikë.

Atëherë, propozimi për kriterin e parë është 83 pikë, niveli i vlerësimit “Shumë mirë”.

Sa i përket kriterit të dytë “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, konkretisht 2.A.a. Respektimi i afateve ligjore. Referuar burimeve të vlerësimit në tërësi rezulton që gjyqtari ka treguar kujdes të lartë për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (deri në 2 ditë) si dhe zbritet koha gjatë se cilës gjyqtari ka kryer lejen vjetore, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 43 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (43 çështje), në raport me çështjet që kanë qenë me afat ligjor (281 çështje), rezulton të jetë 15.3 %, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me 12 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkallim të afatit ligjor, (ii) ngarkesën e gjyqtarit si relator (në total për 1 vit ka gjykuar 652 çështje, nga të cilat 42.5 % apo 281 çështje janë me afat ligjore); (iii) faktin se ai e ka tejkaluar standardin sasior mesatar me 57 % apo me 107% të çështjeve në kushtet kur ai ka ushtruar edhe detyrën e zëvendëskryetarit të gjykatës, çka nënkupton një ngarkesë më të ulët në punë, dhe (iii) aspektet që lidhen me kushtet e punës, konkretisht angazhimin si anëtar i trupave gjykues, kohën që gjyqtari kalon në zhvillimin e seancave, faktin se gjatë periudhës së vlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit efektivisht në detyrë me dy gjyqtarë, propozohet që për këtë kriter gjyqtari duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa më sipër vlerësoj se për këtë tregues aftësia e tij është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.A.b. Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Edhe këtu është pasqyruar në mënyrë të detajuar një analizë e dosjeve të cilat kanë pasur standard minimal. Për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal (98 çështje) me numrin total të çështjeve për të cilat

zbatohet standardi minimal (371 çështje) që rezulton 26.4 %; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) tejkalin e standardit sasior të zbatueshëm në masën me 114 çështje, apo me 57% duke e marrë si gjyqtarë, dhe me 107% në rast se konsiderojmë dhe faktin se ai ka ushtruar gjatë këtij viti edhe detyrën e zëvendëskryetarit të gjykatës, (iv) shqyrtimi i një numri të madh të çështjeve me afat ligjor prej 281 çështje, që kërkon angazhim të madh të gjyqtarit, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Për sa më sipër edhe për këtë tregues propozoj vlerësimin e tij maksimal me 5 pikë.

2.A.c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Është konstatuar referuar kategorisë së çështjeve që koha mesatare e çështjeve është më e shkurtër ose e barabartë me standardit për shumicën e kategorive. Referuar metodologjisë, duke qenë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, gjyqtarit duhet të pikëzohet me 4 pikë. Por duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve, faktin se një numër i lartë i çështjeve kanë qenë me afat ligjor, angazhimin e gjyqtarit në trup gjykues, si dhe detyrën e zëvendëskryetarit, propozohet që edhe për këtë kriter gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Rendimenti i përfundimit të çështjeve referuar raportit analitik ka rezultuar 88.22 % përqindje e cila pikëzohet me 6 pikë. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit është 88.22 %, përqindje e cila pikëzohet me 6 pikë, duke pasur parasysh faktin se gjyqtari në këtë periudhë vlerësimi e ka tejkeluar standardin minimal siç e relatuar më sipër dhe në dy treguesit e tjerë, duke vlerësuar dhe faktin se ai gjatë kësaj periudhe ka ushtruar edhe detyrën e kryetarit të gjykatës, vlerësohet se mund të arrihet në një pikëzim maksimal, për sa kohë që gjyqtari e ka tejkeluar standardin sasior me mbi 50 % dhe kushtet e punës kanë qenë të tilla që e kanë bërë të pamundur përfundimin e një numri më të lartë të gjykimeve. Për sa më sipër, edhe për këtë tregues propozohet aftësia e tij maksimale duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor ka rezultuar më e shkurtër se afati procedural. Për sa më sipër, në kushtet kur rezultoi se kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, gjyqtari të pikëzohet me 15 pikë.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore. 2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive

Bazuar në sa parashtrohet tek numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale ka rezultuar se numri i seancave është 2.2 seanca gjyqësore. Për sa më sipër për këtë tregues, dhe faktin që gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, propozohet vlerësimi i tij në nivel maksimal, me 15 pikë.

2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë aftësie mesatare në këtë tregues, evidentuar përgjithësisht në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit të seancave përgatitore apo gjyqësore, duke respektuar përgjithësisht standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur përgjithësisht me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil. Por nuk konstatohet i njëjti kujdes nga gjyqtari në raport me kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve procedurale sipas rregullave procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Procedurës Penale, që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes, planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore kur është e nevojshme, dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale apo me ndjekjen me rigorozitet e fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor, të cilat paraqiten me mangësi. (Janë sqaruar në projektraport).

Sa më sipër për këtë tregues vlerësohet se aftësia e tij është mbi mesatare, duke e pikëzuar me 12 pikë.

Sa i përket treguesit 2.C.a. Rregullshmëria e dokumentacionit.

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik dhe kronologjike, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal. Aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Për sa më sipër aftësia e tij për këtë tregues vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të "Letrës të të drejtave" e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të përzgjedhura me short. Sa më sipër edhe për këtë tregues propozohet pikëzimi i tij me 8 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin "Aftësitë organizative të gjyqtarit" është 90 pikë, vlerësimi "Shkëlqyeshëm".

"Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale" – konkretisht për këtë kriter nuk janë konstatuar të dhëna që mund të ndikojnë në një pikëzim të tij të ndryshëm nga ai maksimal, pasi për të gjithë treguesit ka rezultuar aftësia e tij shumë e lartë, për sa kohë që nuk ka të dhëna që mund të ndikojnë në uljen e këtij vlerësimi. Sa më sipër, për kriterin e tretë propozohet pikëzimi me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

"Aftësitë personale dhe angazhimi profesional", konkretisht 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm. Për sa më sipër për këtë tregues vlerësoj se shkalla e aftësisë së tij është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Në tërësi, rezulton se gjyqtari në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar kujdes të lartë. Për sa më sipër edhe për këtë tregues propozohet pikëzimi i tij maksimal me 15 pikë.

Aftësia për të bashkëpunuar - nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët (duke qenë se kemi mungesë të dhënash lidhur me këtë tregues) është shumë e lartë. Për këtë arsye propozohet pikëzimi me 15 pikë.

4.B.b. Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën. Edhe për këtë tregues rezulton aftësia e tij shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera – 4.C.a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Referuar raportit analitik si dhe akteve të cilat janë administruar, konkretisht vërtetimit të Shkollës së Magjistraturës rezulton se gjyqtari të jetë aktivizuar në trajnime si më poshtë: në 3 (tre) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit (nga data 15.06.2022 deri në datë 01.07.2022), gjithsej 3 ditë trajnimi. Për këtë arsye, duke qenë se referuar metodologjisë së pikëzimit rezulton se janë më pak se 5 ditë është propozuar pikëzimi i tij me 4 pikë.

Për këtë tregues gjyqtari ka paraqitur prova dhe kundërshtime, ashtu si edhe për kriterin e parë, të cilat mund t'i lexojë edhe vetë gjyqtari.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë. Nuk rezultojnë të dhëna lidhur me këtë tregues. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 3 pikë referuar metodologjisë së pikëzimit.

Sa i përket treguesit 4.C.c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale, edhe këtu nuk rezultojnë të dhëna që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 3 pikë.

Edhe sa i përket treguesit “Publikimet ligjore akademike” nuk rezulton që gjyqtari të ketë publikime ligjore gjatë periudhës së vlerësimit. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit të “Aftësisë personale dhe angazhimi profesional” është 75 pikë, niveli i vlerësimit “Shumë mirë”.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është si më poshtë, (propozime që në fakt sa i përket kriterit të fundit nuk janë azhurnuar për sa i përket provave të cilat i ka paraqitur gjyqtari, por gjithsesi do shprehem në përfundim, pasi të dëgjojmë edhe gjyqtarin): 83 pikë për kriterin e parë, 90 pikë për kriterin e dytë, 100 pikë për kriterin

e tretë dhe 75 pikë për kriterin e katërt. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit është 368 pikë (*lapsus, pasi duhet të ishte 348 pikë*), vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë”. Në përfundim janë edhe rekomandimet përkatëse që janë në projektraport. Faleminderit!

Marçela Shehu: Mundem të lutem?

Ilir Rusi: Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Ju thatë që gjyqtari ka paraqitur disa dokumenta dhe prova të tjera. A ndryshon kjo situatën e vlerësuar të propozuar?

Irena Plaku: Kjo ndryshon situatën për shkak se tek vërtetimi i paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës rezultojnë tre seminare dhe tre ditë pjesëmarrje, pasi në një seminar që ka qenë dyditor, rezulton me një ditë pjesëmarrjeje (sipas vërtetimit të Shkollës së Magjistraturës). Gjyqtari nëpërmjet e-mailit i cili ju është vënë dijeni edhe juve, bashkëlidhur edhe një vërtetim lëshuar përsëri nga Shkolla e Magjistraturës, ku rezulton një seminar tjetër me dy ditë pjesëmarrje dhe një aktivitet ku ka marrë pjesë të zhvilluar nga KLGJ-ja dhe nga Gjykata e Lartë në qytetin e Korçës, për të cilat ai ka paraqitur edhe provat përkatëse dhe që të cilat jua kam vënë në dispozicion. Numri për 1 vit duhet së paku 5 ditë trajnimi. Duke marrë parasysh këto, shkon në 6 ditë trajnimi. Kështu që plotësohet kriteri për të marrë pikëzimin maksimal me 20 pikë.

Marçela Shehu: Pra ju keni një propozim ndryshe.

Për ekonomi të procedurës, në qoftë se ju keni një propozim tjetër, mbase gjyqtari për këtë pikë nuk ka kundërshtime dhe mund të merret me diçka tjetër.

Irena Plaku: Po, siç kemi vepruar.

Po duke qenë se është vetë gjyqtari, thashë të dëgjonim edhe vetë gjyqtarin, duke dëgjuar edhe kundërshtimet e gjyqtarit, duke qenë se ka paraqitur prova. Unë jam dakord për rritjen e pikëzimit për këtë tregues duke arritur në nivelin maksimal për shkak se rezultojnë të dhëna të aktiviteteve të tij, që plotësojnë afatin minimal prej 5 ditësh.

Ilir Rusi: Falenderoj edhe zonjën Plaku për relatimin dhe zonjën Shehu për ndërhyrjen.

Ajo çfarë është evidente është racionalizimi i kohës në raport edhe me qëndrimet publike tashmë të deklaruara nga relatorja mbi një aspekt të vlerësimit tuaj. Do i kërkonim zotit {...} që të ndaleshim në ato aspekte të tjera të cilat nuk u prekën nga diskutimi dhe ndërhyrja e zonjës Shehu dhe reflektimi i zonjës Plaku përgjatë këtij relatimi.

Fjala për ju zoti {...}.

{...}: Për sa i përket kriterit të fundit, për çështjen e trajnimeve, nëse ka nevojë... U sqarua. Mos të merrem me këtë pjesë. Ok.

Tek kriteri i parë “Aftësitë profesionale”, vetëm tek ky kriter unë kam paraqitur disa kundërshtime, që vlerësohem me 83 pikë.

Për sa i përket treguesit “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes”, ajo që kam parë unë tek raporti, kritika evidentohet në faqen 7 të këtij projektraporti, vendimi 164 i vitit 2022 me objekt “Dërgimin e çështjes për gjykim dhe pushimin e procedimit penal” dhe kritika qëndron tek pjesa që nuk kuptohet që në pjesën hyrëse, cilësia e gjyqtarit si gjyqtar i seancës paraprake apo të themelit. Tani, për sa i përket këtij vendimi penal unë e sqaroj se objekti në hyrje përgjithësisht ne e shënojmë “dërgim në gjykim” për të pandehurin pasi kështu vjen edhe kërkesa e prokurorit “dërgim në gjykim”. Edhe po të shikosh nenin 332/dh i K.P.Penale në fund gjykata disponon “Gjykata vendosi për dërgimin e çështjes në gjyq”, nuk e thotë që “dërgimin e çështjes në gjykim themeli”. Mund ta kisha thënë edhe “gjykim themeli”, por kështu janë terminologjitë ligjore. Se kjo çështje u dërgua nga ana ime në gjykim themeli prandaj. Gjykim themeli kam bërë vetëm për këtë pushimin e çështjes kurse për pjesën tjetër “dhunë në familje”.. jo, “plagosje e lehtë me dashje”, një vepër penale e kam kaluar në gjykim themeli, kurse një vepër e kam pushuar. Edhe për sa i përket çështjes penale me objekt pushimin, për pjesën hyrëse këtu e kam shënuar siç është kërkesa e prokurorisë për shembull “pushim procedim penal nr. kaq, datë kaq, për këtë vepër penale”. Kjo është terminologji edhe e ligjit, prandaj.

Ndërkohë që, këtu një pjesë tjetër që kritikohet ka të bëjë tek vendimi nr. 65/2022, është faqja 8 e projektraportit “Faktet janë paraqitur në pjesën e parë të vendimit tepër të përmbledhura dhe janë paraqitur më tej në pjesën e vlerësimit të gjykatës në raport me kërkimet e padisë”. Tani, e vërtetë është që në pjesën e parë faktet janë paraqitur të përmbledhura, por vendimi është organizuar “zgjidhje martesë” në mënyrë të atillë që faktet e çështjes tregohen në mënyrë të përshkallëzuar dhe fillimisht jepen të përmbledhura dhe në vijim ato parashtrihen më gjerësisht dhe analizohen në raport me kërkimet përkatëse. Për shembull analizohet instituti i zgjidhjes së martesës apo i ndryshimit të mbiemrit dhe faktet tregohen vetëm në lidhje me këtë institut dhe më pas përqasen me kërkesat e normës. Kam gjykuar që kjo mënyrë organizimi tek vendimi gjyqësor e bën më të lehtë dhe të kuptueshëm për përdoruesit e këtij vendimi. Për këtë tregues unë kërkoj që aftësia të jetë shumë e lartë dhe të vlerësohet me 25 pikë. 20 pikë e ka bërë relatorja, kërkoj 25 pikë.

Tek treguesi “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, edhe këtu ka kritika për pjesën e vendimit, është i njëjti vendim penal që është bërë objekt kritike, është “Dërgim në gjykim dhe pushimi i procedimit penal”. Gjyqtari, thuhet, ka listuar provat por nuk ka analizuar faktet konkrete dhe aktet provuese.

Tani, unë e sqaroj se ky vendim i është dërguar gjyqtarit të themelit për sa i përket akuzës në ngarkim të pandehurit Z.T. dhe analiza është bërë vetëm në ato elementë që i shërbejnë gjyqtarit të seancës paraprake, nëse hetimet janë të plota, janë respektuar të drejtat e të pandehurit. Ky fakt evidentohet edhe në raportin analitik, faqja 5. Ndërsa për pikën e dytë, “pushimin e procedimit penal”, rrethanat e faktit penal janë analizuar në faqen 10, 11 të këtij vendimi. Sepse kritika këtu është që është bërë një konstatim i gjyqtarit por mungon një përshkrim i analizës së fakteve. Unë kam bërë një analizë të çështjes, prandaj janë edhe pikat 10 dhe 11. Kam bërë kryqëzimin e deklarimeve të palëve sepse këtu thelbi i pushimit të çështjes ka lidhje me deklarin e palëve, që është ushtruar dhunë ose jo. Akuza ka qenë dhunë në familje për njërin prej pjesëtarëve. Dhe nga kryqëzimi i deklarimeve të palëve kam arritur në një konkluzion që nuk ka vepër penale dhe kam përmendur edhe faqen ku gjendet ky procesverbal. Nuk e kam parë të nevojshme që të ndërthur të gjitha provat me faktet e çështjes pasi provat kanë qenë të listuara në fillim të vendimit. Me këtë kam ecur. Kështu që gjykoj që këtu është bërë

një analizë nga ana ime të faktit penal. Ndoshta nuk është bërë i gjerë por unë e kam bërë një analizë që kam gjykuar që është e mjaftueshme.

Këto kanë qenë kritikrat që janë bërë kryesisht dhe vlerësimi është dhënë 20 pikë nga relatorja, unë kërkoj të jetë shumë e lartë me 25 pikë.

Tek treguesi “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, këtu vërejtja qëndron tek vendimet e zgjidhjes së martesës, që ka një dominim të analizës ligjore në raport me rrethanat e çështjes. Domethënë thelbi. S’po e marrë fjalë për fjalë. Kjo është e gjitha. Tani unë këtu kam bërë interpretim të zgjeruar të analizës ligjore sepse kam prekur disa institute të Kodit të Familjes (zgjidhjen e martesës, detyrimin ushqimor, përgjegjësinë prindërore) dhe janë bërë citime të disa dispozitave kryesore dhe lidhja e rrethanave është bërë gjithmonë me ligjin e zbatueshëm. Pra e pranoj që ka një zgjerim të analizës ligjore, por kjo është bërë për shkak se janë prekur disa institute të së drejtës familjare dhe normalisht kur preket një institut, preken edhe tre-katër nene që vendosen siç i ka parashikuar ligji edhe në vendim, të plota.

Këto pra ishin pak a shumë sepse unë u mora me thelbin, dominon analiza ligjore në raport me rrethanat e çështjes. Për vendimet me zgjidhje martese, thashë që unë jam zgjeruar sepse ka pasur institute të Kodit të Familjes që jam marrë pak më gjatë.

Për këtë tregues është bërë vlerësimi me 20 pikë. Kërkoj që të bëhet maksimal, 25 pikë.

Këto janë. Për sa i përket trajnimeve është çështje që u diskutua, që u sqarua dhe s’kisha gjë tjetër.

Ky kriter kërkoj që nga 83 pikë, të shtohen 10 pikë dhe totali i vlerësimit të jetë shkëlqyer. Mbetet në vlerësimin e trupit gjykues.

Unë siç e thashë viti 2022 ka qenë edhe vit që ne kemi mbetur me 2 gjyqtarë, detyrat e drejtuesit, ngarkesë plotë. Mbi 700 vendime kam dhënë. Maksimumin kam dhënë. Këto probleme që janë evidentuar këtu, po të jetë kjo ngarkesë do evidentohen gjithmonë. Vlerësojeni vetë.

Faleminderit që më dëgjuat.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ka pyetje nga anëtarët?

Nga relatorja ka ndonjë pyetje?

(Nuk ka pyetje.)

Faleminderit! Mund të largoheni zoti {...} për procedurë, me qëllim që Këshilli të vazhdojë.

{...}: Mirë, faleminderit!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të prezantimit të relacionit të zotit {...}, ka një ndërhyrje nga relatorja.

Irena Plaku: Atëherë, pasi konstatova mbledhjet e pikëve për secilin nga treguesit dhe kriteret e vlerësimit, konstatoj se ka një gabim material, konkretisht pikëzimi për secilin prej kriterëve është i saktë, konkretisht me 83 pikë kriteri i parë, kriteri i “Aftësive profesionale”, 90 pikë është kriteri i dytë i vlerësimit, 100 pikë është kriteri i tretë, dhe “Aftësia profesionale dhe angazhimi profesional” është 75 pikë që është propozuar fillimisht, çka nuk rezulton domethënë, mbledhja e tyre është bërë gabim (është shënuar gabimisht 368), por në fakt duhet të ishte 348 pikë dhe është një gabim material.

Duke qenë se unë propozova rritjen edhe me 16 pikë sa i përket treguesit të angazhimit pranë Shkollës së Magjistraturës dhe kriteri i katërt tashmë nuk është më 75 pikë, por shkon 91 pikë. Atëherë, shuma e përgjithshme e pikëzimit, pasi niveli nuk ndryshon në “shumë mirë”, është 364 pikë. Siç e thashë është bërë një gabim material tek mbledhja e përgjithshme ku është shënuar 368 pikë, ku në fakt mbledhja matematikore rezulton 348 pikë. Ky është një saktësim për sa i përket vetëm mbledhjes matematikore të pikëzimit për secilin prej kriterëve të vlerësimit.

Ilir Rusi: Pra nga ana e relatorit u bë një saktësim në lidhje me vlerën matematikore të treguesve. Njëkohësisht u reflektua edhe ndryshimi i vlerësimit paraprak në lidhje me kriterin “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera”, nga 4 pikë që ishte relacioni

filleshtar, tashmë është 20 pikë, dhe si përfundim nga ana e relatores propozohet vlerësimi i tij në vlerën e 364 pikëve. Pra duke mbledhur shumatoren e të gjithë treguesve vlerësimi në pikë, për këtë moment, i kandidatit, është 364 pikë. Theksoj, saktësim në material dhe reflektim të relatores në lidhje me një vlerësim ndryshe tashmë në lidhje me kriterin “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera”, nga 4 pikë në 20 pikë.

Ftoj anëtarët e KLGJ-së nëse kanë diskutime për më tej.

Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Faleminderit zoti drejtues i seancës.

Duke pasur parasysh, pas njohjen me raportin, kundërshtimet e magjistratit, duke pasur parasysh volumin e punës që ai ka përballuar në gjykim të çështjeve (si numër), gjithashtu volumin e punës si edhe drejtues i asaj gjykate, me atë numër të reduktuar në periudhën për të cilën bëhet fjalë, si dhe në analizë të vendimmarrjeve të cilat u cituan në projektraport dhe që u kundërshtua një pjesë nga ana e gjyqtarit, unë propozoj që për “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik” për të cilën ky gjyqtar është vlerësuar me 20 pikë, propozoj që të vlerësohet “shumë e lartë” me 25 pikë, pasi edhe mënyra e shprehjes apo e shprehive të tij të përdorura edhe në vendimmarrjet, pra që kanë të bëjnë me cilësinë e vendimmarrjes dhe argumentimit logjik, shoh që për kategorinë e çështjeve të gjykuara është në atë nivelin shumë të lartë. Ky është propozimi im. Faleminderit!

Ilir Rusi: Atëherë zoti Hallunaj, tek “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, tek seksioni B, pika c. Cilësia e analizës dhe argumenti logjik, propozoni që nga vlerësimi 20 pikë, të jetë në vlerësimin 25 pikë.

Po, faleminderit!

Të tjera propozime?

Alban Toro: Atëherë, gjithmonë tek “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, tek pika B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit, duke marrë për bazë dhe në konsideratë aktet e administruara në dosjen e vlerësimit dhe kushtet specifike që ka

operuar kjo gjykatë, me ngarkesën specifike, propozoj t'i shtohen 2 pikë vlerësimi të cilin ka bërë relatorja, pra nga 8 të bëhet në 10. Faleminderit!

Ilir Rusi: Pra për ta perifrazuar, nëse më lejon. Pra ka një propozim të dytë nga zoti Toro, që në lidhje me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, tek seksioni B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit, të ketë një vlerësim jo 8 pikë të propozuar nga relatorja por në vlerën e 10 pikëve, duke shtuar 2 pikë.

Ka propozime, diskutime të tjera nga anëtarët?

Ka një reflektim nga ana e relatores?

Irena Plaku: Pasi dëgjova dy anëtarët sa i përket propozimeve, në lidhje me propozimin e bërë nga zoti Toro, mendoj se vërtetë gjyqtari ka pasur ngarkesë të lartë të punës, për këtë reflektohet tek “Aftësitë organizative” ku për shkak të ngarkesës, megjithëse ka rezultuar me afate të parespektuar ligjore, në atë gradë, të cilat janë cituar, duke pasur parasysh edhe këtë ngarkesë dhe faktin se ai ka kryer edhe detyrën e zëvendëskryetarit apo ka qenë me dy gjyqtarë, unë i kam rritur vlerësimet me dy kritere, i kam çuar edhe në nivel maksimal. Por “Aftësitë organizative” konkretisht me ngarkesën nuk mund të cenojnë kriterin e parë të vlerësimi. Gjithashtu do të them se për këtë tregues, konkretisht struktura e qëndrueshme e vendimit, janë konstatuar vërtetë ato mangësi të cilat janë pasqyruar në projektraport, të cilat ndër të tjera unë mendoj se cenojnë edhe procesin e rregullt ligjor, për shkak se lidhen me palët të cilët njoftohen; e qartësinë e vendimit për sa i përket vendimit që shkon në gjykatën më të lartë; kur palët nuk janë pasqyruar siç duhet, janë shtuar palë apo objekti, vërtetë ka ngarkesë por objekti i çështjes për të cilën ka shkuar për gjykim është shënuar “dërgim në gjyq” dhe më pas shikon që është vendim themeli; këto kanë të bëjnë me qartësinë e vendimit dhe strukturën e qëndrueshme, prandaj janë ulur 2 pikë. Tek kjo pjesa e dypikëshit çfarë është konstatuar është lidhur edhe me elementët që kanë të bëjnë tek dispozitivi i vendimit. Gjyqtari nuk është i qartë për sa i përket nëse vendimi gjyqësor është titull ekzekutiv apo jo. Lëshohet titull ekzekutiv, të cilin e ke të përcaktuar tek neni 510 i Kodit të Procedurës Civile. Kështu që prandaj është bërë një propozim i tillë. Gjithsesi, unë i qëndroj propozimit, siç e thashë.

Edhe për pjesën e analizës unë vlerësoj se nuk mund të jetë shumë e lartë, pasur parasysh mangësitë të cilat janë konstatuar. Konstatohet në disa vendime që kopjohen faktet të cilat janë pasqyruar tek pjesa e parë dhe kjo nuk ka të bëjë me analizën ligjore (thjesht duke u marrë dhe duke u vendosur); nuk integrohen por vetëm përshkruhen. Vendimet kanë natyrë përshkruese dhe jo analizuuese. Prandaj janë ulur “mbi mesatare”. Gjithsesi, në vlerësim të Këshillit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime nga anëtarët? Ndonjë propozim?

(Nuk ka diskutime.)

Nëse nuk ka diskutime, fillimisht kalojmë në votimin e propozimit të zotit Hallunaj në lidhje me kriterin e “Cilësisë së analizës dhe argumentit logjik” që propozohet një vlerësim nga 20 pikë në 25 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Miratohet propozimi i zotit Hallunaj.

Ilir Rusi: Hedhim në votim propozimin e zotit Toro në lidhje me “Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar e vendimit”, për të cilën propozohet nga një vlerësim 8 në 10 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Miratohet propozimi përkatës.

Ilir Rusi: Në vijim të këtij vlerësimi për zotin {...}, për dy kritere në lidhje me “Cilësinë e analizës dhe argumentit logjik” tashmë ka një vlerësim prej 25 pikësh dhe në lidhje me “Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar” ka një vlerësim prej 10 pikësh, pra ka një vlerë të shtuar prej 7 pikësh, dhe në matematikën që reflektuam pas korigjimit matematikor (të bërë nga një lapsus), rezulton në 371 pikë.

Është e saktë 371 nga mbledhja matematikore?

Irena Plaku: Sipas pikëve që u miratuan në Këshill, kriteri i parë shkon në “Shkëlqyeshëm” me 90 pikë, duke qenë se u shtuan 7 pikë dhe shkon “Shkëlqyeshëm” dhe niveli i përgjithshëm tashmë nga 364 pikë, do t’i shtohen edhe 7 pikë të tjera dhe shkon në 371 dhe niveli i vlerësimit tashmë ndryshon nga “shumë mirë” në “Shkëlqyeshëm”.

Ilir Rusi: Atëherë, në reflektim të relatimit të diskutimeve, prezantimit të zotit {...}, të votimit të propozimeve, rezultoi që për kriterin e “Aftësive profesionale”, tashmë vlerësimi nga 83 është në 90 pikë, ndërsa “Aftësitë organizative” – “Shkëlqyeshëm” me 90 pikë, “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” – “Shkëlqyeshëm” me 100 pikë, “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” është 91 pikë, me një vlerësim total i tij është prej 371 pikësh, duke e ndryshuar vlerësimin nga niveli “Shumë mirë” i vlerësimit në nivelin “Shkëlqyeshëm”.

Atëherë, hedhim në votim këtë projekt-akt, në reflektim edhe të këtyre ndryshimeve, në lidhje me vlerësimin e përgjithshëm të tij.

Irena Plaku: Atëherë, meqenëse u miratua nga shumica për sa i përket ndryshimit të vlerësimit, unë duke qenë se votova kundër, do i qëndroj kundër vlerësimit të përgjithshëm “Shumë mirë” (“Shkëlqyeshëm”) dhe pikëzimit të tij. Kështu që jam kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit z. {...}, për vitin 2022:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”; – 90 pikë.

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”; – 90 pikë.

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”; – 100 pikë.

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brikena Ukperaj**.

Shënim: **Zonja Llagami** largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.**
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 9. BIRN.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes plenare, vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë” i ndryshuar dhe në zbatim të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është organi përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht Ligji nr. 96/2016, ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magistratit, me pëlqimin e tij, në institucione të tjera brenda sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu dhe në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në lidhje me rastin në shqyrtim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar shkresa e datës 31.07.2023, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes të cilës Këshillit i është kërkuar komandimi i dy magistratëve gjyqtarë në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Vlerësimi i Komisionit:

Për sa më lart, mbështetur në nenin 86, shkronja “d”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenet 53, 54, 55, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, bazuar në kërkesën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Sipas projektvendimit, Këshillit i propozohet të shpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e 2 (dy) pozicioneve të lira “inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Me anë të këtij projektvendimi, rregullohet shpallja e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit “inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kohëzgjatja, kushtet, kriteret dhe procedura e komandimit.

Struktura e projektvendimit:

Projektvendimi është i strukturuar në dy krerë sipas projektit që ne e kemi përcjellë. Jepet shpjegimi për secilin nga krerët e projektvendimit.

Në përfundim kërkohet miratimin e tij.

Përpara se sa ta diskutojmë, pasi shqyrtova edhe një herë projektvendimin së bashku me relacionin kam dy çështje për t'i diskutuar/parashtruar Këshillit. Së pari, po të shikoni në projektvendim, afati i paraqitjes së kërkesës për komandim është lënë bosh për ta diskutuar me njëri-tjetrin. Unë mendoj/propozoj dy javë kohë, siç kemi lënë zakonisht dhe duhet thënë/specifikuar që afati i paraqitjes së kërkesës për komandim është deri më datë 05.10.2023. Është pika 3.

E dyta, po të shikojmë pikën 8 dhe kjo është çështje për t'u diskutuar, kandidati duhet të plotësojë kushtet për emërimin në Gjykatën e Lartë si më poshtë: është kërkesë ligjore kjo, dhe të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet; pika që unë dua të ndalem për ta diskutuar është “të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas ligjit tonë 96/2016, sepse është kriteri ynë ligjor, si dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; Përveç kësaj, çështja për t'u diskutuar është dhe unë propozoj që të shtohet “pasi të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit sipas ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pse? Sepse neve në qoftë se do të fillojmë verifikimin e figurës dhe pasurisë etj., për gjyqtarët që kërkojnë të ngrihen në detyrë, e kemi të kufizuar kohën, pra nga viti 2017 e në vijim. Pjesën më përpara është ligji 84 i vitit 2016 që bën verifikimin e tre kriterëve (profesionale, figurës dhe të pasurisë). Pra nuk duhet që edhe për atë periudhë kohore siç bëjmë për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kandidatët të kenë kaluar procesin e vetting-ut me një vendim të formës së prerë dhe më pas ne të vijojmë pjesën tjetër të kohës që duhet për të bërë verifikimin e kriterëve të tjera ligjore, që janë kushtet formale dhe kriteret e vlerësimit të verifikimit dhe figurës. Nuk e di nëse isha i qartë për këtë pjesën.

Unë nuk e kam shënuar, por është çështje për t'u diskutuar. Se nëse nuk do ta shënojmë, ne do fillojmë verifikimin jo përpara vitit 2017, se nuk e kemi kompetencë për ta verifikuar, vitin 2017 e në vijim, por kandidati do vlerësim edhe përpara vitit 2017 sepse duhet të ketë një përvojë pune prej 13 vjetësh si gjyqtar.

I jam përmbajtur strikt atyre kërkesave që parashikon ligji në këtë rast.

Dhe kjo është arsyeja, a duhet ta shtojmë edhe këtë?

Për mua bën sens ta shtojmë. Duhet të ketë kaluar vetting-un.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Me gjithë reflektimin tuaj për afatin e paraqitjes dhe me një klauzolë nëse e kanë kaluar po s'e kanë kaluar vetting-un kandidatët, ftoj anëtarët për të bërë diskutime, në reflektim edhe të propozimeve të tanishme të zotit Kurushi.

Në vijim të relatimit të zotit Kurushi, fjala është për zonjën Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Shqetësimi dhe diskutimi që ngre zoti Kurushi është i drejtë në fakt, sepse procesi i rivlerësimit është një proces i cili do të vononte edhe procesin e komandimit të magjistratëve në Gjykatën e Lartë. Por nga ana tjetër, duke iu referuar ligjit përkatës për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë na rezulton që ky kriter, pra kalimi i procesit të vetting-ut nuk parashikohet si një kriter ligjor, nuk përcaktohet në ligj si kusht ligjor për t'u kualifikuar si një kandidat i mundshëm për të kandiduar si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në këto kushte, për të ruajtur edhe standardin që ka ndjekur Këshilli deri tani në rastin e kandidimeve për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit, në gjykatat e posaçme apo në Gjykatën e Lartë, ku në çdo rast kanë kandiduar të gjithë kandidatët, të cilët kanë kaluar ose jo procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga organet e rivlerësimit, atëherë vlerësoj që kjo mundësi, pra për të kandiduar si inspektor, t'u jepet sërish të gjithë magjistratëve. Më tej, sigurisht që do të pritet procesi i rezultateve të vetting-ut për të vijuar me verifikimin që do të bëjë Këshilli.

Kështu që, për një trajtim të barabartë të të gjithë gjyqtarëve dhe për një standard të barabartë me të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë që ndjek Këshilli, unë mendoj që ky kusht nuk duhet të shtohet nga ana jonë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diçka nga relatori në vijim?

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Nuk po zgjatem shumë. Nëse të gjithë kolegët janë dakord që t'i qëndrojmë projektit të parë, unë tërheq këtë pjesën tjetër të çështjes që e kisha në shqetësimin tim për ta trajtuar dhe për ta diskutuar bashkërisht. Meqenëse po shikoj që mbase kemi një dakordësi me atë çfarë kemi propozuar fillimisht, tërheq propozimin e dytë për këtë pikë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime të tjera nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Nëse nuk ka diskutime, hedhim në votim këtë projektvendim me reflektimin fundor të zotit Kurushi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidaturë nga radhët e gjyqtarëve”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidaturë

1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Shpalljen e kërkesës për kandidaturë, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për 2 (dy) pozicione të lira si inspektor.

Ilir Rusi: Zonja Shehu është “online”. Ndërkohë edhe zonja Luli është “online” dhe vullnetin e saj e shpreh nëpërmjet platformës.

Fatmira Luli: Pro. (Zonja Luli voton gjatë kohës që po lexohej vendimi i miratuar nga anëtarët e tjerë.)

Ilir Rusi: Atëherë, me ndihmën edhe të stafit, u konfirmua edhe vullneti i zonjës Shehu (zonjës Luli) për këtë projektvendim, që është dakord me propozimin.

Kështu që në vijim po vazhdoj të lexoj vendimin “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

I. Hapjen e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për 2 (dy) pozicione të lira si inspektor.

3. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është deri më datë 05.10.2023.

4. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të shkronjës “dh”, pika 5, të nenit 209, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

dh) Vërtetim/Dëshmi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) për mosqenien i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Dokumentacioni sipas pikës 4, të këtij vendimi, dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Kohëzgjatja, kushtet, kriteret dhe procedura e komandimit

5. Kohëzgjatja e komandimit është deri në pesë vjet.

6. Kohëzgjatja e komandimi mund të përfundojë para afatit:

a) me kërkesë të gjyqtarit të komanduar, për shkaqe të justifikuara;

b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;

c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;

ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;

d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra.

7. Kushtet e përgjithshme të komandimit:

a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:

i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;

ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës.

8. Kushtet e veçanta të komandimit:

a) Kandidati duhet të plotësojë kushtet për emërim në Gjykatën e Lartë, si më poshtë:

i) të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

ii) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;

b) në kohën e kandidimit, të mos jetë kryetar i një gjykate ose anëtar i organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata ose sindikata magjistratësh etj;

c) të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale;

ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) të mos jetë i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) në kohën e kandidimit, të mos ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të Ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ose të afërm të shkallës së parë, që punon si inspektor në Zyrën e Inspektorit e Lartë të Drejtësisë.

9. Plotësimi i kushteve të kandidimit, me përjashtim të atij sipas shkronjës “a”, pika 7 dhe shkronjës “c”, pika 8, të këtij vendimi, verifikohen sipas procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

10. Kandidati, që me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet se plotëson kushtet e kandidimit, me përjashtim të atij sipas shkronjës “a”, pika 7, të këtij vendimi, i nënshtrohet vlerësimit etik dhe profesional sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimit të tij nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, ose Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimit të tij nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.

11. Këshilli mund të vendosë në çdo kohë përjashtimin nga komandimi kur verifikohet që kandidati nuk plotëson qoftë edhe një prej kushteve të komandimit, me përjashtim të atij sipas shkronjës “a”, pika 7, të këtij Vendimi.

12. Brenda dy javëve pas përfundimit të verifikimit të kushteve të kandidimit sipas pikës 9, si dhe të vlerësimit etik dhe profesional sipas pikës 10, të këtij vendimi, për të gjithë kandidatët që rezultojnë me nivel vlerësimi të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionet për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin.

13. Emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet për komandim, së bashku me Opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përcillen menjëherë për vlerësim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

14. Përzgjedhja e kandidatëve për vendet vakante në pozicionin e inspektorit, bëhet me vendim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

15. Brenda dy javëve nga marrja e vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kërkesës së tij për komandim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin e gjyqtarëve të përzgjedhur, në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli**** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Shënim: *Zonja Llagami* largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.*
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 9. BIRN.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023, për kandidaten znj.

{...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Me vendimin nr. 248, ndërmjet të tjerave ka paraqitur kërkesë në procedurën e lëvizjes paralele kërkuesja, magjistratja znj. {...}. Më tej zonja {...} paraqet kërkesën për heqje dorë nga procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023. Kjo kërkesë është paraqitur në Këshill më datë 26.07.2023.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar që duke u ndodhur para kësaj situate t’i propozojë Këshillit përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua nga relatori?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”*:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli**** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 9. Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Shënim: *Zonja Llagami* largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.*
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 9. BIRN.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë

Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Ky relacion në fakt i referohet pozicionit të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023 që bën fjalë për lëvizjen paralele për një vend të lirë në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Relacioni ka lidhje me këtë vendim që ne sapo e miratuar dhe votuar bashkërisht që bën fjalë për renditjen e kandidatëve.

Pa humbur kohë po them në mënyrë të përmbledhur relacionin përkatës.

Pra më datë 24.05.2023 KLGJ hapi procedurat për lëvizje paralele duke referuar edhe pozicionin nr. 248, pozicion në të drejtën civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Brenda këtij afati që u përcaktua në atë vendim të KLGJ-së, u paraqitën disa kërkesa, ndërmjet të cilave dy kërkesa, që janë zonja {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe gjyqtari {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023, Këshilli vendosi: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në verifikim Komisioni/Këshilli mori parasysh kriteret që i referohen përvojës profesionale minimale, mospasjes masë disiplinore në fuqi, mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale (nenet 43, pika 6 dhe nenit 8 të ligjit “Për statusin”).

Kandidatët e kualifikuar nga procedura e verifikimit të kriterëve ligjore ishin zonja {...}, si dhe zoti {...}.

Këshilli me Vendimin nr. 468, datë 25.07.2023, caktoi nëpërmjet shortit relatorin e përzgjedhjes për pozicionet e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan edhe për pozicionin që i referohet vendimit nr. 248 të përmendur më lart.

Më datë 24.07.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75 e vijuese të

Vendimit të Këshillit nr. 320/2020, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionin e lirë, si dhe për caktimin e relatorit.

Më datë 26.07.2023 nëpërmjet postës elektronike kandidatja znj. {...} ka shprehur vullnetin e saj për tërheqjen nga kandidimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 248/2023 dhe vijimin e kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 253/2023.

Këshilli me vendimin e sotëm të datës 21 shtator 2023, vendosi: “...Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi..”.

Ndodhur në këto kushte, siç u parashtrua, në pikat 4-5 të këtij relacioni, kandidati i vetëm i kualifikuar mbetet z. {...}.

Kandidati z. {...} i diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2016 qershor 2019) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4122.97 pikësh, nga 4450 të mundshme.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë lëvizje paralele ka kandiduar vetëm një kandidat dhe për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut VI, Seksioni Ç të Vendimit 320/2020.

Projektvendimi është i strukturuar në tre pika.

Pika e parë e projektvendimit propozohet të miratohet renditja e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele ku si kandidat i vetëm është z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e këtij vendimi të arsyetuar i njoftohet kandidatit sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të tij.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të këtij projektvendimi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 248, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 248, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 250, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli**** (anëtare)
4. ***Irena Plaku**** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Shënim: *Zonja Llagami* largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.*
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 9. BIRN.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 250, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 250, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë

Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Relacioni dhe projektvendimi janë të ngjashëm me atë çfarë përmenda më lart. Bëhet fjalë për një pozicion tjetër, atë të shpallur me vendimin nr. 250/2023. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 250/2023 kandiduan kandidatët e mëposhtëm: {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe zonja {...}, gjyqtarë pranë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Zoti {...} me kërkesën e datës 11.07.2023 ka hequr dorë nga kandidimi për këtë pozicion, duke mos filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele për pozicionin nr. 250 të përmendur më lart.

Kandidatja znj. {...} me kërkesën e datës 03.07.2023 ka hequr dorë nga kandidimi për këtë pozicion, duke mos filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele.

Ndodhur në këto kushte mbetet i vetëm në garë zoti {...}.

Me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023, Këshilli vendosi: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet ndër të tjera nr. 250, 24.05.2023, ku u caktua edhe relatori përkatës për kandidatin që do të bënte verifikimin e kriterëve ligjore.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit të kandidatëve të kriterëve të mëposhtëm: “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, për të cilat kandidati nuk rezultoi të kishte problem në verifikimin e këtyre kriterëve ligjore.

Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që kanë aplikuar ishte z. {...}, që në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ai të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me

Vendimin nr. 452, datë 24.07.2023, vendosi kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 250 datë 24.05.2023.

Këshilli me Vendimin nr. 468/2023, caktoi nëpërmjet shortit relatorin e përzgjedhjes për pozicionet e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Me këtë vendim, që u përzgjodha unë si relator, u njoh edhe kandidati në procedurën e lëvizjes paralele.

Siç u parashtua, në pikat 4-5 të këtij relacioni, kandidati i vetëm i kualifikuar për pozicionin e përmendur më lart në këtë garë është i vetëm dhe i përket kategorisë së kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional. Hapat dhe kriteret për renditjen e tyre janë parashikuar në mënyrë të detajuar në seksionin Ç.1 të Kreut VI të vendimit 320/2020 të KLGJ-së.

Në zbatim të pikës 106, të Vendimit të Këshillit 320/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës për kandidatët e kualifikuar, që gjendej në dosjet e tij personale.

Konkretisht, lidhur me vlerësimin e Shkollës së Magjistraturës, për kandidatin u konstatua se z. {...} i diplomuar në vitin akademik 2019-2020 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2017 – qershor 2020) dhe ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4005.68 pikësh, nga 4450 të mundshme, me vlerësimin në përqindje prej 90.02%.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë lëvizje paralele ka kandiduar vetëm kandidati z. {...} dhe për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave të tjera, të parashikuara në Kreun VI, Seksioni Ç të Vendimit 320/2020 të KLGJ-së.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika. Projektvendimi ndodhet përpara kolegëve dhe nuk besoj se është e nevojshme që ta përmend edhe një herë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit për relatimin zoti Kurushi!

Kalojmë në se ka diskutime apo jo nga anëtarët.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të këtij projektvendimi.

Zonja Plaku!

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 250, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 250, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli**** (anëtare)
4. ***Irena Plaku**** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Shënim: *Zonja Llagami* largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.*
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 9. BIRN.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë

Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Me vendimet e datës 24.05.2023 KLGJ, ndër të tjera me vendimin nr. 253, hapi procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale.

Afati i kandidimit ishte deri më datë 14.06.2023. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale kandiduan gjyqtarët e mëposhtëm: znj. {...}, gjyqtarë pranë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit për kandidatët vijoi procesi i verifikimit të kriterëve formale.

Kandidatja znj. {...} me kërkesën e datës 12.07.2023 ka hequr dorë nga kandidimi për këtë pozicion, duke mos filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 253.

Në vijim, me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023, Këshilli vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për dy kandidatët e mbetur në garë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit të lëvizjes paralele, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit të kandidatëve të kriterëve të mëposhtme: “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që kishin aplikuar janë:

1 Për kandidaten znj. {...}, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele, Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 451, datë 24.07.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin nr. 248...

Për kandidaten znj. {...}, Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kritereve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 465, datë 25.07.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 253/2023.

Këshilli me Vendimin nr. 468, datë 25.07.2023, caktoi nëpërmjet shortit relatorin e përzgjedhjes për pozicionet e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes u caktua kryetari i Komisionit dhe ky njoftim iu njoftua kandidatëve.

Pika 102 e vendimit 320/2020 parashikon se: “Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.”

Në zbatim të pikës 106, të Vendimit të Këshillit 320/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës për kandidatët e kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikën dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimin të kritereve të kandidimit. Relatoi administroi edhe certifikatat e vlerësimit të Shkollës së Magjistraturës pasi kandidatëve nuk mundet t’u bëhej vlerësimi nga KLGJ-ja.

Lidhur me vlerësimet e Shkollës së Magjistraturës, për kandidatet u konstatua se:

Kandidatja znj. {...} e diplomuar në vitin akademik 2019-2020 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2017 – qershor 2020) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4180.49 pikësh, nga 4450 të mundshme.

Kandidatja znj. {...} e diplomuar në vitin akademik 2019-2020 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2017 – qershor 2020) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4067.20 pikësh, nga 4450 të mundshme.

Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë pika 8 dhe 9 e nenit 43 të Ligjit për Statusin.

Po ashtu, për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të Vendimit 320/2020.

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 253, datë 24.05.2023, u përfshinë dy kandidatet e përmendura më lart (konkretisht: znj. {...} dhe znj. {...}).

Për renditjen e kandidatëve, u ndoq hapi i vetëm i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 8, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin.

Sipas përcaktimeve të pikës 8, të nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe pikës 101, të Vendimit 320/2020 ku parashikohet se: “Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim ...”, ka rezultuar:

Referuar kriterit të renditjes, pra atij sipas “renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës”, për kandidatët u konstatua:

Për kandidaten znj. {...} a) Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3-vjeçare, kandidatja është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Për kandidaten z. {...} sipas certifikatës së vlerësimit për periudhën 3-vjeçare, kandidatja është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “renditjes së të diplomuarve”, rezultoi që kandidatja znj. {...} dhe kandidatja znj. {...}, të kenë nivelin e vlerësimit “Shumë mirë” në renditje. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të vlerësimit të Shkollës për kandidatët, janë identifikohet dy kandidate me rezultate të njëjta në nivelin e vlerësimit, znj. {...} dhe kandidatja znj. {...}. Për pasojë, renditja e kandidatëve nuk mund të bëhet sipas nivelin të përgjithshëm.

Duke vijuar me përparësitë të parashikuara nga pika 103 nuk rezulton që ndonjë prej kandidateve të ketë përvojë si gjyqtar i komanduar apo në skemën e delegimit.

Në pikën 105 të vendimit 320/2020 përcaktohet se: “Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 103, të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.”

Nga listat e klasifikimit të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për vitin qershor 2020 ka rezultuar se: i) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4180.49 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 93.94 % të pikëve totale; ii) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4067.20 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.40 %, të pikëve totale.

Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, sipas listës së klasifikimit të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 253/2023.

Renditja bazohet në vlerësimet e marra nga kandidatët e diplomuar në raport me pikët e mundshme. Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 253/2023, rezulton si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};

Bazuar në sa përcaktohet në pikat 18-24, të këtij vendimi, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 26 të tij, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253/2023”.

Projektvendimi për renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253/2023, u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 11.09.2023.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën e parë të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253/2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}.

Në pikën e dytë të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e

vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për vëmendjen!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim projektvendimin.

Zonja Plaku!

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Rusi: Zonja Luli!

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1.Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë

të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli* | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku* | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Shënim: *Zonja Llagami* largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.*
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 9. BIRN.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 8 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët, me vendimin nr. 504, 21.11.2022 KLGJ ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, në fushën e së drejtës penale. Një nga kandidatet ka qenë {...}, për të cilën nga ana e Këshillit janë kryer disa veprime procedurale, më i fundit daton në 2023, ku me vendimin nr. 205, datë 26.04.2023, pasi është konstatuar plotësimi i kriterëve formale, janë vijuar procedurat e tjera të verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Ndërkohë, mbas këtij momenti, nga ana e gjyqtarës paraqitet dhe depozitohet një dorëheqje, në të cilën parashtrohet se: Unë e nënshruara {...} që aktualisht ushtroj detyrën e Zv. Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me anë të kësaj kërkesë kërkoj heqjen dore nga procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo kërkesë depozitohet për te pasur mundësi për te aplikuar ne procedura te tjera për ngritjen ne detyre. Duke shpresuar qe kërkesa ime do te shqyrtohet ne një kohe sa me te shkurtër dhe duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm”. Kjo ishte përmbajtja e dorëheqjes së magjistrates.

Duke qenë se ky lloj shkaku përfaqëson ose përfshihet në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019 si një nga shkaqet për të ndaluar procedurën e mëtejshme, nga ana e relatorit është përpiluar projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju propozohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Zonja Plaku!

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli**** (anëtare)
4. ***Irena Plaku**** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brikena Ukperaj**.

Shënim: **Zonja Llagami** largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.**
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 9. BIRN.**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 9 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Me vendimin nr. 12/2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Për këtë pozicion në përfundim të fazës I – verifikimit të kriterëve ligjore janë kualifikuar 4 (katër) kandidatë, konkretisht: i) znj. {...}; ii) z. {...}; iii) z. {...}; iv) znj. {...}.

Znj. {...} është tërhequr nga kandidimi për pozicionin nr. 12 dhe Këshilli me vendimin nr.345, datë 27.06.2023 vendosi: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12/2023.

Znj. {...} është tërhequr nga kandidimi për pozicionin nr. 12 dhe Këshilli me vendimin nr. 330, datë 21.06.2023 vendosi: Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele edhe për këtë kandidate.

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 12/2023, u përfshinë dy kandidatë, konkretisht: z. {...} dhe z. {...}.

Në përfundim të procedurës së renditjes, Këshilli me vendimin nr. 434, datë 18.07.2023 vendosi:

“1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12/2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...};
2. Z. {...}

Një kopje vendimit t’i njoftohej kandidatëve përkatës.

Kundër këtij vendimi mund të bëhej ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Vendimi i mësipërm i është komunikuar kandidatëve rregullisht. Nëpërmjet komunikimit elektronik datë 24.07.2023 nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, është marrë dijeni se ndaj vendimit nr. 434, datë 18.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është ushtruar ankim. Në këto kushte vendimi i Këshillit nr. 434/2023 është i

formës së prerë. Në përputhje me përcaktimet e VII, të vendimit të tij nr. 320/2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Komisioni i propozon Këshillit transferimin e kandidatit të renditur më lart, z. {...} në pozicionin e lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Projektvendimi është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën e parë përcaktohet – Transferimi i gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjyqtari z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, si edhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ai ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit.

Lidhur me efektet juridike të këtij vendimi, mbajtur në konsideratë: i) situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; ii) emërimet e magjistratëve të diplomuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, propozohet që të efektet juridike të këtij vendimi të fillojnë, ne propozojmë datën 28.09.2023, pra afërsisht një javë. Kemi ndjekur të njëjtin standard që kemi ndjekur edhe me gjyqtarët e tjerë kur kemi vendosur transferimet e tyre.

Në pikën vijuese parashikohet që një kopje e këtij vendimi i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Së fundmi, përcaktohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë...

Irena Plaku: Pro.

Klodian Kurushi: Më falni edhe një herë për specifikim. Në pikën 3 të projektvendimit kemi lënë që efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 28.09.2023. Në pikën 2 të projektvendimit themi që gjyqtari z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë, të shtohet “Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”.

Ilir Rusi: Hedhim në votim projektvendimin, duke saktësuar edhe afatin përkatës që parashikohet në pikën 3 dhe terminologjia në lidhje me gjykatën, sipas hartës së re gjyqësore.

Zonja Plaku!

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Gjyqtari z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, si edhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ai ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit.

3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 28.09.2023.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 20, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli**** (anëtare)
4. ***Irena Plaku**** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Shënim: *Zonja Llagami* largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.*
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 9. BIRN.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 20, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 20, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele, ndër to, edhe me vendimin nr. 20, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në këtë pozicion kanë kandiduar disa gjyqtarë: z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 20/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale. Në këtë listë janë përfshirë janë përfshirë këta kandidatë si më poshtë: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Më vonë është vijuar procedura duke u verifikuar kriteret ligjore të kandidimit që janë pasja e “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Kandidatët e kualifikuar siç edhe relatova janë: znj. {...}, për të cilën Këshilli, me vendimin nr. 180, datë 25.04.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile; kandidatja znj. {...}, për të cilën me vendimin nr. 185, datë 25.04.2023, është kualifikuar dhe ka vijuar procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile; kandidati z. {...}, për të cilin me vendimin nr. 188, datë 25.04.2023, është vendosur kualifikimi dhe vijimi i procedurave.

Në vijim të procedurave për lëvizjen paralele kandidatët e kualifikuar janë njoftuar për të gjitha procedurat dhe nuk ka shfaqur ndonjë pretendim.

Në vijim të procedurës së përzgjedhjes në lëvizjen paralele për kandidatët në këto pozicione ka rezultuar se:

Zoti {...} është renditur i pari në pozicionin nr. 18 dhe Këshilli me vendimin e datës 13.09.2023 ka vendosur transferimin e tij në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sa më sipër në renditje për këtë pozicion janë kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}.

Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidatët: u konstatua se:

Për kandidaten znj. {...}

a) Sipas Vendimit të KLGJ nr. 364, datë 13.09.2022, kandidatja është vlerësuar për periudhën 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, me total 385 pikë.

b) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 433, datë 18.07.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, me numër të pikëve 391.

Për kandidaten znj. {...}

a) Sipas Vendimit të KLGJ nr. 335, datë 21.06.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 380 pikë.

b) Sipas Vendimit të KLGJ nr. 440, datë 19.07.2023, kandidatja është vlerësuar për vitin 2022, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 388 pikë.

Vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatëve janë konstatuar të jenë bërë përfundimtarë.

Është vijuar pastaj me renditjen e kandidatëve dhe duke pasur parasysh procedurën për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 20, janë përfshirë dy kandidatë: znj. {...} dhe znj. {...}. Për këto kandidate u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ato ishin kualifikuar në procedurën e lëvizjes paralele ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet nga ligji.

Siç relatova, referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për të mos rënë në përsëritje, për

zonjën {...}, dy vlerësimet janë 385 pikë vlerësimi për periudhën 2013-2016 dhe 391 pikë për periudhën 2017-2019. Vlerësimi është "Shkëlqyeshëm".

Për znj. {...} është vlerësimi "Shkëlqyeshëm" për të dy vlerësimet. Për vlerësimin për periudhën 2017-2019 ka 380 pikë në total dhe për vitin 2022, 388 pikë.

Nisur nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas "niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale", rezulton që kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, të kenë "Shkëlqyeshëm" dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Në këto rrethana nuk është e mundur renditja e kandidateve sipas këtij kriteri, pasi ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta. Për të vijuar më tej tek përparësia tjetër – "niveli i vlerësimit të fundit", rezulton se dy kandidatet e kanë nivelin e vlerësimit të fundit "Shkëlqyeshëm".

Në vijim, në zbatim të pikave 84 - 86 të vendimit 320/2020 përcaktohet se: "84. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 82 ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në skemën e pikëve të miratuar nga Këshilli [...]. 86. Sipas kriterit të renditjes të parashikuar në pikën 84, të këtij vendimi, kandidati me totalin më të lart të pikëve në dy vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale, renditet më lart."

Siç konstatohet, kandidatja znj. {...} ka gjithsej 776 pikë, ndërsa kandidatja znj. {...} ka gjithsej 768 pikë.

Nga zbatimi i përparësisë së tretë për kriterin e parë të renditjes, asaj sipas "skemës së pikëve të miratuar nga Këshilli", është e mundur renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta, si më poshtë:

- 1) Znj. {...} - 776 pikë;
- 2) Znj. {...} - 768 pikë.

Për pasojë renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 20, datë 18.01.2023 është si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...}.

Bazuar në sa më sipër është paraqitur edhe projektvendimi i cili është përpiluar në tre pika.

Në pikën e parë të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë, si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidateve znj. {...} dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Znj. Plaku!

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 20, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};

2. Znj. {...}.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”**:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli* | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku* | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brikena Ukperaj**.

Shënim: **Zonja Llagami** largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.**
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 9. BIRN.**

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes, në lidhje me pikën 11 të parashikuar për t’u shqyrtuar në këtë mbledhje plenare, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kërkesën e z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i cili ishte përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në fillim të kësaj mbledhjeje Këshilli vendosi që shqyrtimi i kësaj tematike të bëhet në një mbledhje të ardhshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor (*shih procesverbalin e pikës së parë*).

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve në grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli**** (anëtare)
4. ***Irena Plaku**** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Shënim: *Zonja Llagami* largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 8. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.*
- 9. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 10. BIRN.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve në grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 12 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve në grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën zotit Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse se jeni në dijeni, me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), për vitin 2023. Ky buxhet ka qenë i ndarë në tre programe buxhetore, programi 01110, programi 01140 dhe programi 03310.

Fondet buxhetore në programin 03310, janë miratuar dhe detajuar në shumën prej 4,025,000 mijë lekë, (nga të cilat vetëm në shpenzime kapitale 716,000 mijë lekë), të detajuara në 5 kode projektsh: “Studime dhe Projektme”, “Programe Software për gjykatat”, “Rikonstruksion”, “Blerje pajisje elektronike”, “Blerje orendi e pajisje zyre”, “Blerje mjete motorike”.

Realizimi i fondeve në investime për 8-mujorin për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në investime janë realizuar në masën 11.3%. Realizimi është i lidhur me dy fakte kryesore të cilat kanë ndikuar në këtë realizim siç është çelja në thesar bërë nga Ministria e Financave në fund të muajit prill të fondeve në investime për gjithë grupin buxhetor. Dhe ajo çfarë është më e rëndësishmja, gjysma e këtyre fondeve u çelën të ngrira. Pra fondet në vlerën 361,800 mijë lekë e cila konsiston në kodin e projektit “Programe Software për gjykatat” u çel i ngrirë. Me gjithë korrespondencën disamujore ndërmjet KLGJ-së dhe Ministrisë së Financës, vetëm në fund të gushtit u çel një pjesë e këtyre fondeve, u ngurtësua në vlerën 150,000 mijë lekë e cila konsistonte në disa projekte që ishin ekzistuese që kishin filluar implementimin e tyre që në vitin buxhetor 2022 dhe një pjesë e tyre që ishin të programuara në këtë vit buxhetor.

Në këto kushte, struktura përgjegjëse për investime në KLGJ së bashku me Departamentin e Administrimit të Gjykatave dhe Departamentin të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, duke u mbështetur në një memo dhe informacion shtesë të bërë nga dhe Drejtoria e Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, si dhe nga Departamenti i Shërbimeve Administrative, ku duke parë shkaqet e pamundësisë kohore të realizimit të këtyre investimeve për sa i përket programeve software, kanë kërkuar të ndryshojë destinacioni i përdorimit të tyre duke i kaluar nga një kod projekti në tjetrin, në kodin e projektit “Pajisje elektronike” e cila

konsiston në blerjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të gjithë nevojat e sistemit gjyqësor. Këto nevoja janë identifikuar si nga një pjesë e vogël të ngelura të paplotësuara gjatë vitit buxhetor 2023 e në vazhdim, por edhe ato nevoja të cilat janë programuar gjatë përgatitjes së dokumentit të PBA 2024-2026, dokument i cili u miratua nga Këshilli në fund të muajit gusht dhe është përcjellë pranë Ministrisë së Financave.

Kështu, duke iu referuar edhe analizës buxhetore të bërë edhe këtyre dy dokumenteve/materialeve të sjella nga departamentet përkatëse në Këshillin e Lartë Gjyqësor, arrihet në konkluzionin që të pakësohen fondet në vlerën 63,400 mijë lekë në kodin “Programe Software për gjykatat”, pra ajo çfarë unë thashë që është e pamundur për t’u realizuar, që konsistojnë në disa programe që ishin programuar për t’u realizuar si projekti i digjitalizimit, projekti i pajisjeve softwareve për ICMIS-in e ri, Disaster Recovery, regjistri elektronik OJF, infrastruktura mbështetëse për ICMIS-in e ri, dhe ishin edhe projektet e reja të cilët do të realizohen në këtë vit buxhetor: projekti për zhvillimin e një aplikacioni web për regjistrin elektronik të urdhrimit mbrojtjes, projekti e-inspektori, projekti i nënshkrimit elektronik dhe projekti për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve.

Për sa i përket projektit të menaxhimit të çështjeve (ICMIS-it të ri), i cili ka qenë programuar, miratuar dhe detajuar fondi prej 212,000 mijë lekë, aktualisht janë edhe sot që unë po relatoj përpara Këshillit janë të çelura nga ana e Ministrisë së Financës por të ngrira në degën e thesarit. Kështu, duke qenë përpara këtij fakti, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe me efikasitet të fondeve përgjatë vitit 2023 si dhe mosdiegja e tyre në fund të vitit buxhetor, duke vlerësuar dhe ndryshimet e destinacionit, Departamenti i IT-së, me qëllim realizimin e blerjes së pajisjeve elektronike për sistemin gjyqësor, duke referuar kërkesave (siç e citova edhe më sipër) të pasqyruara në kërkesat buxhetore të PBA-së 2024-2026 dhe nevojat e paplotësuara gjatë vitit buxhetor 2023 janë vlerësuar në shumën 126,887 mijë lekë.

Këto fonde janë vlerësuar nga analiza e bërë për t’u shtuar në kodin e projektit “Blerje pajisje kompjuteri” në vlerën 114,450 mijë lekë, në “Blerje mjete motorike” në vlerën 6,300 mijë lekë, në vlerën 4,400 mijë lekë në “Ndërtim i ri, rikonstruksion i plotë”, kërkesë e cila ka ardhur nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm i Apelit Tiranë, e cila konsiston në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga viti 2022 për realizimin e

punimeve të rikonstruksionit që është bërë në këtë gjykatë. Gjithashtu një kërkesë gjatë viti buxhetor në vazhdim na ka ardhur edhe nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë për përmirësimin e elementëve të sigurisë në arshiva, mbështetur në kërkesën e paraqitur nga gjykata e cila është bërë më datë 08.09.2023. Kemi programuar t'i shtojmë vlerën 2,100 mijë lekë në kodin “Blerje orendi e pajisje zyre”.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së shqyrtimin dhe miratimin e relacionit mbi rishpërndarjen e fondeve buxhetore, programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime kapitale (230-231) për vitin buxhetor 2023, duke pakësuar fondet në kodin e projektit “studime dhe projektme” duke pakësuar në projektin “rikonstruksion i pjesshëm” dhe në “programe software”, si dhe në projektin “blerje pajisje zyre”; shtimin e këtyre fondeve në projektin “blerje mjete motorike”, në projektin “blerje pajisje kompjuterike”, si dhe në projektin “rikonstruksion i pjesshëm” dhe kodin “blerje pajisje zyre” për Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, sipas pasqyrave bashkëlidhur që të gjithë i keni përpara.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Ilir Rusi: Ka diskutime nga anëtarët për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Zonja Plaku!

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Rusi: Znj. Luli!

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve në grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) së fondeve buxhetore, në grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime kapitale (230, 231), për vitin 2023, sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur, pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2023)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 21.06.2023, 27.06.2023, 06.07.2023 dhe 13.07.2023.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:26 dhe mbaroi në orën 14:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës “online”*::

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli* | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku* | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brikena Ukperaj**.

Shënim: **Zonja Llagami** largohet pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv pranë INFOÇIP.**
- 8. Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 9. BIRN.**

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 21.06.2023, 27.06.2023, 06.07.2023 dhe 13.07.2023.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën e fundit të kësaj mbledhjeje plenare, pika 13, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 21.06.2023, 27.06.2023, 06.07.2023 dhe 13.07.2023.

Ka diskutime nga anëtarët mbi përmbajtjen e tyre?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdohet me votimin e projektvendimit përkatës.

Zonja Plaku!

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Rusi: Znj. Luli!

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 21.06.2023, 27.06.2023, 06.07.2023 dhe 13.07.2023.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Pasdite të qetë.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor